



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 22.05.2023

Nr: 119

Ora: 12:30

VENDIM

**PËR PUSHIMIN E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 61, DATË 20.05.2023 TË DEPOZITUAR
NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA LËVIZJA E LEGALITETIT"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 22.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Subjekti zgjedhor "Partia Lëvizja e Legalitetit", përfaqësuar nga z. Fred Nela dhe z. Shpëtim Axhani

OBJEKT: Kundërshtim i vendimeve nr. 808, datë 16.05.2023 të KZAZ nr. 41 dhe nr. 1461, datë 16.05.2023 të KZAZ nr. 37, bashkia Tiranë "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjet e Këshillit bashkiak Tiranë"

BAZË LIGJORE: Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Data: 22.05.2023 Nr: 119
Ora: 12:30



"Për pushimin e shqyrtimit të kërkesës ankimore nr. 61, datë 20.05.2023 të depozituar nga subjekti zgjedhor "Partia Lëvizja e Legalitetit"

VËREN:

Subjekti zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit” ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën ankimore, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 61 regj., datë 19.05.2023. KAS konstatoi se kjo kërkesë ankimore nuk i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, pasi është paraqitur me të meta, duke qartësuar palës ankimuese se mungojnë vendimi i KZAZ që kundërshton, provat bashkëlidhur, si dhe një përshkrim më i detajuar i fakteve dhe rrethanave konkrete.

Me anë të vendimit nr. 116, datë 18.05.2023, KAS vendosi kthimin e kërkesës ankimore për plotësim të elementeve të formës, me një afat 24 orë, si dhe zhvillimin e seancës paraprake më datë 22.05.2023, ora 12:30.

Në mbledhjen e datës 22.05.2023, ora 12:30, pas relatimit të z. Ledio Braho u konstatua se kërkesa ankimore përsëri nuk i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, pasi mungon vendimi që ankimohej, më saktë mungon Vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ku miratohet “Tabela Përmbledhëse e Rezultateve të Zgjedhjeve”, e cila duhet miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sipas nenit 123 të Kodit Zgjedhor.

Pasi Komisioneri të shprehet me vendim mbi miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e këshillit të bashkisë Tiranë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, nga data e shpalljes së vendimit, subjektet zgjedhore mund të ankimojnë vendimin brenda 5 (pesë) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja “c” dhe në nenin 143, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

VENDOSI:

1. Pushimin e shqyrtimit të kërkesës ankimore nr. 61, datë 20.05.2023 të subjektit zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit”.

2. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1, të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot më datë 19.05.2023.

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar